



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine – Ministry of Labour and Social Welfare

27.12.2018, Prishtinë

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTET NGA FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim MPMS fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës 27.12.2018 të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të;
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar apo angazhuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: adelina.hasani@rks-gov.net deri me datën 18.01.2019.

Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale Ndërtesa e Re e MPMS-së pranë Hotel Grandit, Sheshi Zahir Pajaziti, N.N, 10 000, Prishtinë- Zyra e Personelit në MPMS.

MPMS do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës 27.12.2018 të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.